

Komponenti Nr.5

Titulli :Rinovimi,transferimi dhe demonstrimi i teknologjive te kultivimit te bimeve foragjere, fasules dhe bimeve te tjera bishtajore

Rekomandimet e pjesshme

- Ne zonen e ulet bregdetare te vendit jonxha te mbillet ne afatin 25 shkurt-15 mars, ku krahas kultivarit Tomin te perhapet gradualisht dhe kultivari Cufe.
- Ne pleherimin baze te jonxhishteve te reja, duhet te perdoren rreth 200 kv/ha pleh organik, kombinuar me 4 kv/ha superfosfat.
- Ne kushtet e mbajtjes se jonxhishteve 5- 6 vjeçare, duhet te perdoren rreth 60 kg/ha l.a fosfor ne koperture.
- Ne parcelat e tersheres per kokerr duhet te perdoren rreth 66 kg/ha l.a azot, fraksionuar ne tri faza, 2-3 gjethe, vllazerim dhe ngritje.
- Ne zonen e ulet bregdetare te vendit fasulja duhet te mbillet ne periudhen 1-15 prill.
- Ne ngastrat e fasules direkte, duhet te sigurohen 300-350 mije bime/ha, ose te perdoret nje norme fare ne kufijte 110-130 kg/ha.
- Ne tokat e varfra dhe me pjellori mesatare duhet te perdoren rreth 49 kg/ha l.a azot.
- Ne zonen e ulet bregdetare fasulja duhet te bashkeshoqerohet me rreth 15 mije bime misri, sepse ne kete menyre fermeri siguron rreth 25-30 mije leke/ha.
- Bima e koçkules, per marrjen e rendimenteve te larta si mase e njome dhe kokerr duhet te mbillet ne 10 ditorin e pare te shkurtit ne distancen e rreshtave 30-45 cm.

- Ne ngastrat per haselle duhet te marrin peparasi bashkeshoqerimet buxak+tershere dhe teffill+lolium.
- Ne ngastrat me terfil nuk duhet te perdoret azot, ndersa ne bashkeshoqerimet e terfilit dhe buxhakut me lolium dhe tershere duhet te perdoren rreth 100 kg/ha l.a azot.
- Ne zonat kodrinore dhe malore, per krijimin e livadheve dhe kullotave artificiale lotusi duhet te bashkeshoqerohet me telishin, ku edhe ne kushte pa uje merren deri ne 400 kv/ha.
- Ne tokat acide duhet te predominojne livadhet me baze lotusin, ku merren rreth 70 % me shume mase e njome se foragjeret e tjera shumevjeçare.
- Ne parcelat e mbjelle me lotus, per njomishte dhe per prodhim fare duhet te kryet pleherimi siperfaqsor me rreth 100 kg/ha l.a fosfor.

***Drejtuesi i projektit
Dr. Adrian DOKO***